



V E N D I M
K.P.P. 642/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.10.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e BOE “IKN” sh.p.k. & “A&E Engineering” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “*Shërbim Konsulence*”, me objekt “*Shpenzime supervizioni, Kontratë Mirëmbajtje Rajoni Qëndror Tiranë*”, me nr. REF-73964-06-07-2018, me fond limit 22,899,675 lekë (pa TVSH), zhvilluar faza I në datën 20.06.2018, nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “C.E.C Group” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

BOE “IKN” sh.p.k. & “A&E Engineering” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Eduart Mano”, P.20, K 0, Tiranë.

Autoriteti kontraktor:

Autoriteti Rrugor Shqiptar
Adresa: Rr. “Sami Frasheri”, Nr 33, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 08.06.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Shërbim Konsulence*”, me objekt “*Shpenzime supervizioni, Kontratë Mirëmbajtje Rajoni Qëndror Tiranë*”, me nr. REF-73964-06-07-2018, me fond limit 22,899,675 lekë (pa TVSH), zhvilluar faza I në datën 20.06.2018, nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2 Në datën 20.06.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën I të procedurës së prokurimit.

II.3.Në datën 29.06.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “C.E.C Group” shpk	Kualifikuar;
2. “Gjeokonsult & Co” shpk	Kualifikuar;
3. “Infratech” shpk	Skualifikuar;
4. “A.Sh. Engineering” & “ITM” shpk	Skualifikuar;
5. “IKN” & “A&E Engineering” shpk,	Skualifikuar;

II.4.Nga verifikimet e kryera, rezulton se BOE “IKN” sh.p.k. & “A&E Engineering” sh.p.k. është njoftuar nëpërmjet Sistemit e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për skualifikimin e tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, për arsyet si më poshtë vijon:

“2. Kriteret e vecanta per kualifikim 2.3 Kapaciteti Teknik 2.3.3 Një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe komponenteve te saj, lista e personelit te përfshihen CV-të e tyre , diplomen, kontraten e punes, si dhe licencat profesionale, kur kane te tilla. Mungon Lista e stafit kryesor, te nevojshem per te zbatuar objektin e prokurimit, te permbaje: Nuk percaktohet se kush eshte : Menaxherin e Projektit , 2 inxhinier terreni , inxhinjer gjeolog ose gjeoteknik si dhe ixhinieri per sigurine rrugore per te vleresuar eksperiencen sic kerkohet DST.

2.3.6 Dëshmi per mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten si me poshte: Zyre me siperfaqe jo me te vogel se 70 m2 (ne Rajonin e Tiranes) ne pronesi ose me qera. Per zyren ne pronesi te paraqitet pronesia e objektit, ndersa per zyre me qera te paraqitet kontrata noteriale e qerese me nje afat kohor sa afati i realizimit te kontrates. Nuk percaktohet destinacioni per zyra e paraqitur pasi ne kontrate eshte paraqitur shtepi banimi.”

II.5.Në datën 06.07.2018 BOE ankimues “IKN” sh.p.k. & “A&E Engineering” sh.p.k., ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e këtij të fundit për skualifikimin e tij, si dhe ngre pretendime mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “C.E.C Group” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6.Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 5986/2 Prot. datë 12.07.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën BOE ankimues “IKN” sh.p.k. & “A&E Engineering” sh.p.k., duke mos e pranuar atë.

II.7.Në datën 20.07.2018 BOE ankimues “IKN” sh.p.k. & “A&E Engineering” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

*“[...]Lidhur me pikën e parë të skualifikimit duam të theksojmë se sipas DST të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit thuhet: *Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi. Nga bashkimi ynë i operatorëve ekonomikë, për të përmbushur pikën 2.3.3 të DST është paraqitur dokumentacioni në lidhje me stafin e nevojshëm të kërkuar në dokumentat e tenderit, atë kryesor dhe mbështetës, për të gjitha specialitetet dhe profilet e kërkuara (inxhinierë ndërtimi që të plotësojnë kriteret e vendosura për Menaxher projekti, inxhinierë terreni (2 dy), inxhinier mjedisi, inxhinier gjeolog, inxhinier për sigurinë rrugore.) duke u shoqëruar me licencat, CV-të, kontratat e punës, diplomat, dokumentacion ky i paraqitur sipas kërkesave tuaja në dokumentat e tenderit, nëpërmjet të cilave evidentohen profesionet, kualifikimet, profilet e punës dhe eksperiencat e mëparshme të realizuara prej tyre. Stafi i propozuar nga bashkimi i Operatorëve Ekonomikë i plotëson kriteret e vendosura në DST duke ju referuar vlerësimit në fazën e short listimit, dhe sa më sipër mungesa fizike e listës së stafit nuk lë vend për ndonjë paqartësi apo mosplotësim kriteresh nga Operatori ynë. Sqarojmë se në stafin tonë kemi shumë më tepër se ç’na kërkohet në DST. Po ju paraqesim më poshtë vetëm numrin e stafit me deklaratë disponueshmërie pasi kapacitet tona janë shumë më të mëdha të cilët marrim përsipër të jenë në dispozicion të projektit. Lidhur me pretendimet e AK se mungon lista, për ne është vlerësuar si kërkesë minimale pra nëse themi duhet 1 Menaxher projekti ky është minimumi ne si Bashkim Operatorësh kemi 5 të tillë e kështu me rradhë. Numri i inxhinierëve që plotëson experiencën për menaxher projekti është 5 inxhinierë. (Kërkohet 1); Numri i inxhinierëve që plotësojnë experiencën për inxhinierë terreni është 4 inxhinierë. (Kërkohen 2); Numri i inxhinierëve për mjedis është 2 inxhinierë. (Kërkohet 1); Nr. i inxhinierëve gjeologë është 1 inxhinier, i cili Drejtues Teknik dhe staf permanent. (Kërkohet 1 me kohë të pjesëshme); Inxhinier për auditim të sigorisë 1 inxhinier që e kemi në staf permanent dhe Drejtues Teknik (Bashkëngjitur edhe Certifikatë Aftësie për Auditues/Inspektues i Sigurisë Rrugore) që tregon se ne si OE jemi më të kompletuar se çdo Operator tjetër i cili mund ta paraqesë me kontratë provizore. (Kërkohet 1 me kohë të pjesëshme). Gjykimi i komisionit, që duhej të bëhej emërtimi që në këtë fazë nuk është i drejtë, pasi në këtë fazë mund të skualifikosh nëse Bashkimi i Operatorëve nuk ka ose nuk plotëson me stafin që vë në dispozicion minimumin e kërkesave, ndërkohë që ne i tejkalojmë disa “herë. Ne gjykojmë që vlerësimi i kësaj pike me listë është për fazë e dorëzimit të ofertës ku stafi që do paraqitet do të vlerësohet sipas eksperiencës. Për më tepër që ne duke u nisur nga fakti që marrim pjesë në shume procedura dhe stafi angazhohet në mënyrë dinamike, duam të jemi konkretë dhe të saktë për të paraqitur dhe dhënë më të mirën e mundur në kohën e duhur. Nisur dhe nga natyra e këtij lloj shërbimi, ne jemi të bindur se për një shërbim cilësor numri i stafit të kërkuar nga AK nuk është Optimal, për këtë arsye ne kemi paraqitur më shumë.*

Përsa i përket pikës së dytë që lidhet me Zyrën e paraqitur, ju sqarojmë se: Është e Vërtetë që në Kontratën e Premtim Shitje për Apartament në pronësi të kompanisë "A&E Engineering" lexohet Apartament banimi, por kjo pronë e gjendur në pallatin "IVEA" 3/5, rruga Islam Alla, Tiranë është adresa e Selisë Qëndrore të Kompanisë "A&B Engineering" gjë që vërtetohet edhe nga Ekstrakti Historik bashkëngjitur te Shtojcat, i nxjerrë nga QKB. Duam të theksojmë se edhe zyrat e paraqitura nga dy operatorët e shortlistuar janë apartamente në pallate banimi sic vërtetohet edhe nga Ekstraktet Historike të këtyre dy kompanive (bashkëngjitur) dhe në Faqet e Internetit të tyre dhe përkatësisht: Kompania "Gjeokonsult" ka si adresë: -. Pallati "Mëhillaj" , kati 4, Kashar, Tiranë, pranë Spitalit Grek "Hygeia". Kompania CEC Tiranë Njësia Bashkiake nr.7 Rruga Dritan Hoxha, Ndërtesa nr.117, Shkalla nr.2 Apartamenti nr.5/3. Kur ky fakt nuk është skualifikues për dy operatorët e kualifikuar, mendojmë se edhe për ne ky pretendim bie poshtë. Ne kemi dyshimet tona se komisioni për këtë kërkesë të DST ka vlerësuar me dy standarte. Konkretisht Operatori Ekonomik i kualifikuar (short listuar) "C.E.C Group" shpk, nuk plotëson kriterin 2.3.1 sipas DST. Ky OE ka paraqitur si shërbim të ngjashëm në dokumentat e Tenderit të zhvilluar Kontratën e Mbikqyrjes së punimeve: "Plotësimi dhe përfundimi i objektit Ndërtim Unaza e Madhe e Tiranës (Segmenti, Komuna e Parisit - Shkolla teknologjike, pjesa e mbetur, Km 0.00-0.640". Vetë vërtetimi i lëshuan nga AK e tregon se kjo kontratë supervizimi është fiktive dhe e pasaktë që nuk mund të merret në konsiderate për punime të ngjashme. Konkretisht vërehet në vërtetim vërehet se: Data e nënshkrimit të Kontratës nga Autoriteti Kontraktor është 03.07.2017 në një kohë që data e përfundimit të punimeve të Kontratës është 12.03.2017 dhe kur data e fillimit të kontratës është 20.03.2017. Referuar datave dhe të dhënave të mësipërme kemi të bëj më me kontratë fiktive që do të thotë nuk plotëson kushtin për tu konsideruar si eksperiencë nga AK pavarësisht se është i njëjti AK. Jemi të bindur gjithashtu se dhe eksperiencat e tjera të paraqitura nga ky Operator nuk plotësojnë kriterin 2.3.1 sipas DST-së (Bashkëngjitur nje kopje e Formularit të Vlerësimit e paraqitur për këtë kontratë shërbimi nga "C.E.C Group" shpk). Ne kërkojmë që të vlerësohet me kujdes gjithë dokumentacioni i kësaj kontrate pasi ky supervizim është fiktiv dhe për pasojë nuk mund të shërbejë si kontratë e ngjashme. Një gjykim dhe Vlerësim të drejtë në lidhje me kriterin 2.3.3 dhe kriterin 2.3.6 të DST-së për ne si Operator Ekonomik pasi duket qartë që plotësohen nga ne, për rrjedhojë dhe short listimin. [...]"

II.8.Në datën 31.07.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.5986/3prot., datë 27.07.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “IKN” sh.p.k. & “A&E Engineering” sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: *[...]Mungon Lista e stafit kryesor, te nevojshem per te zbatuar objektin e prokurimit, te permbaje: Nuk percaktohet se kush eshte: Menaxherin e Projektit , 2 inxhinier terreni , inxhinier gjeolog ose gjeoteknik si dhe ixhinieri per sigurine rrugore per te vleresuar eksperiencen sic kerkohet DST [...]*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në shtojcën 10, pika 2.3.3 “Kapaciteti Teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon: *“2.3.3 Një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe komponenteve te saj, lista e personelit te përfshihen CV-të e tyre , diplomën, kontratën e punës, si dhe licencat profesionale, kur kane te tilla.*

Lista estafit kryesor, te nevojshem per te zbatuar objektin e prokurimit, te permbaje:

- Menaxher Projekti (1 nje) – Inxhinier rrugësh me përvojë, mbi dhjetë (10) vjet përvojë në projektet inxhinierike civile, duke përfshirë të paktën kater (4) vjet eksperience në mbikqyrjen e mirëmbajtjen e rrugëve ose mbikqyrje punime rrugore.*

- Inxhinier Tereni (2 dy)- Inxhinier rrugësh , te cilet duhet te kene mbi 7 (shtate) vjet experience ne projekte e zbatimin e rrugeve nga te cilat te pakten 4 (kater) vjet experience ne mirembajtje ose ne mbikqyrje punime rrugore .*

- Nje(1) inxhinier mjedisi me kohë të pjesëshme për gjithë kohezgjatjen e kontrates, ndare sipas Rajoneve.*

- Nje(1) inxhinier gjeolog/ gjeoteknik me kohë të pjesëshme 4 muaj për gjithë kohezgjatjen e kontrates,*

- Nje(1) inxhinier për sigurinë rrugore (me çertifikate “Audituese/Inspektues te sigurise rrugore) me kohë të pjesëshme 4 muaj për gjithë kohezgjatjen e kontrates”*

III.1.2.Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.1.3.Në nenin 28, pika 5, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht: *“5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

a) *licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*

c) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

ç) *dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

d) *“Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”*

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE ankimues, KPP konstaton se, në përmbushje të kriterëve të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit objekt shqyrtimi, bashkimi i operatorëve ankimues ka paraqitur një sërë kontratash individuale pune të stafit të tyre, shoqëruar me licensa profesionale, certifikime, CV, librezë pune etj, por rezulton se nuk është paraqitur lista e personelit kryesor sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në shtojcën 10, pika 2.3.3 “Kapaciteti Teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Komisioni gjykon se, me kriterin e vendosur autoriteti kontraktor kërkon që operatorët ekonomik pjesëmarrës nëpërmjet listës të përcaktojnë në mënyrë eksplicite ndarjen e përgjegjësisve të personelit të tyre kryesor, duke përcaktuar se cili do të ketë përgjësine për kryerjen e funksionit të menaxherit të projektit, cilët do të jenë dy pjestarët e personelit që do kenë përgjegjësinë për kryerjen e funksionit të inxhinierëve të terrenit, e në vijim me kryerjen e funksioneve të tjera të përcaktuara në kriterin e sipërcituar, me qëllim identifikimin e tyre nga ana e autoritetit kontraktor, në mënyrë që të kryej verifikimet përkatëse mbi eksperiencat e kërkuara. Në këto kushte, mos dorëzimi i listës së personelit kryesor nga ana e BOE ankimues, e bën të pamundur për autoritetin kontraktor identifikimin e ndarjes së përgjegjësisve, e për rrjedhojë edhe verifikimin e eksperiencave për secilin pjestar të personelit të ankimuesit sipas funksionit që do të kryej gjatë zbatimit të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson të theksojë, se kriteri i përcaktuar në shtojcën 10, pika 2.3.3 “Kapaciteti Teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga autoriteti kontraktor, është një kriter plotësisht i bazuar në rregullat e prokurimit publik, përkatësisht në pikën 5/b të nenit 28, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion

realizimit me sukses të kontratës. Gjithashtu, kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Përsa më sipër, BOE ankimues "IKN" sh.p.k. & "A&E Engineering" sh.p.k. nuk e përmbush kriterin e sipërcituar të vendosur nga autoriteti kontraktor.

III.1.6.KPP thekson se kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se *"[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]"*.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues "IKN" sh.p.k. & "A&E Engineering" sh.p.k. nuk qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimin e BOE ankimues "IKN" sh.p.k. & "A&E Engineering" sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: *"[...]Nuk percaktohet destinacioni per zyra e paraqitur pasi ne kontrate eshte paraqitur shtepi banimi. [...]"*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1.Në shtojcën 10, pika 2.3.6 "Kapaciteti Teknik", në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon: *"2.3.6 Dëshmi per mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten si me poshte:*

- Automjet, tip 4x4 cope 2 ne pronesi ose me qera, kur jane ne pronesi te paraqetet çertifikata e pronesise, siguracioni, çertifikata e kontrollit teknik. Per automjetet me qera te paraqitet kontrata noteriale e qerase me afat deri ne realizimin e plote te kontrates, siguracioni i automjetit, çertifikata e kontrollit teknik.*

•Zyre me sipërfaqe jo me te vogel se 70 m2 (ne Rajonin e Tiranes) ne pronesi ose me qera. Per zyrem ne pronesi te paraqitet pronesia e objektit, ndersa per zyre me qera te paraqitet kontrata noteriale e qerases me nje afat kohor sa afati i realizimit te kontrates.

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të BOE “IKN” sh.p.k. & “A&E Engineering” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të sipërcituar, rezulton se është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

- Kontratë premtimi shitje për apartament, nr.2443rep., nr.495kol/2, datë 01.07.2010, me palë Z. Th. P. dhe Znj. L. P. në cilësinë e shitësit dhe Znj. E. Ç. në cilësinë e blerësit.

III.2.3.Në nenin 53/3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*

III.2.4. KPP sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

III.2.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar të paraqitur nga BOE ankimues, konstatohet se është paraqitur një kontratë premtimi shitje për apartament, me shitës dy persona fizik dhe blerës një tjetër person fizik, me objekt shitjen me premtim të një apartamenti banimi me sipërfaqe 133 m². Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të sipërcituar të paraqitur në përmbushje të kriterit kualifikues, nga ankimuesi nuk vërtetohet fakti i disponimit me pronësi apo me qera të një ambienti zyrë me sipërfaqe 70 m² në rajonin e Tiranës, pasi në nenin 2 (Përshkrimi i Pronës) të kontratës së paraqitur, specifikohet se destinacioni i kësaj pasurie është apartament banimi dhe jo zyrë.

Nga ana tjetër, KPP konstaton se palë kontraktore në cilësinë e blerësit në këtë kontratë është Znj. E. Ç dhe asnjë prej shoqërive tregtare pjesëtare të bashkimit të operatorëve ankimues, si pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi. Nga shqyrtimi i ekstraktit të shoqërisë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Znj. E. Ç, rezulton se është ortak i vetëm i kësaj shoqërie. Referuar edhe legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, në asnjë moment nuk përcaktohet që gjithçka në pronësi të ortakut si person, është edhe në pronësi të shoqërisë, në të cilën ky person është ortak, pasi janë dy subjekte të ndryshëm, që gëzojnë personalitet juridik të ndryshëm. Në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 68, përcaktohet shprehimisht se: “1. *Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një shoqëri tregtare, e themeluar nga persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.* 2. *Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti.* 3. *Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara nuk mund të ofrojnë kuotat e tyre si mjete investimi për publikun e gjerë.* 4. *Me përjashtim të rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe, marrëdhëniet ndërmjet ortakëve mund të përcaktohen në statutin e shoqërisë.* 5. *Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Statuti përcakton mënyrat e shlyerjes së kontributeve.* 6. *Ortakët e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar i vlerësojnë kontributet në natyrë në marrëveshje të ndërsjella me njëri-tjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre në para. Nëse nuk mund të arrihet një marrëveshje, secili prej ortakëve mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse, për të ngarkuar një ekspert vlerësues, me një vendim me efekt detyrues. Raporti i ortakëve ose i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me të dhënat e tjera të kërkuara për regjistrim*”. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, referuar legjislacionit të sipërcituar, janë shoqëri të themeluara nga persona fizikë ose juridikë, të cilët kanë përgjegjësi dhe përgjigjen për detyrimet e shoqërisë deri në pjesën e kapitalit të nënshkruar. Në interpretim të dispozitës së sipërcituar të legjislacionit për shoqëritë tregtare, në rastin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, çdo pjesëmarrje tjetër duhet bërë përmes shprehjes formale të vullnetit, pra nëpërmjet një akti ku deklarohet shprehja e vullnetit të palëve.

III.2.6. Në dokumentat e tenderit, është përcaktuar në mënyrë të qartë që operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë në pronësi një ambient zyrë ose kur nuk e ka në pronësi mund të paraqesë një kontratë qeraje. BOE ankimues nuk ka paraqitur certifikatë pronësie në emër të shoqërive pjesëmarrëse apo kontratë qeraje me palë qeramarrëse këta të fundit në këtë procedurë prokurimi, që minimalisht të presupozohej se ambienti i disponuar do të ishte zyrë për shkak të përdorimit prej tyre. Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e ankimuesit në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues “IKN” sh.p.k. & “A&E Engineering” sh.p.k. nuk qëndron.

III.3.Lidhur me pretendimet e BOE ankimues “IKN” sh.p.k. & “A&E Engineering” sh.p.k. mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “C.E.C Group” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.3.1.Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

III.3.2.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për këtë arsye, këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e BOE “IKN” sh.p.k. & “A&E Engineering” sh.p.k. për procedurën e prokurimit, *“Shërbim Konsulence”, me objekt “Shpenzime supervizioni, Kontratë Mirëmbajtje Rajoni Qëndror Tiranë”, me nr. REF-73964-06-07-2018, me fond limit 22,899,675 lekë (pa TVSH), zhvilluar faza I në datën 20.06.2018, nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.*
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedures së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1294 protokolli Datë 20.07.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha